



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN**

Elbasan, më 12.02.2024

**Procesverbal -Tipi i kontrates - Mall**

*(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)*

**OBJEKTI I PROÇEDURËS -“Blerje materiale pastrimi dhe detergjente të ndryshem per QEA”**

**LLOJI PROÇEDURËS - “Proçedurë e hapur e thjeshtuar – mallra”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodi CPV: 39224000-8 - Fshesa, furça dhe artikuj të tjerë të ndryshëm, 39831200-8 - Detergjentë**

**VLERA E FONDIT LIMIT - 5,678,851 (pesëmilion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tetëmijë e tetëqind e pesëdhjetë e një)lekë pa t.v.sh.**

Ne baze të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontrator Bashkia Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipercituar, me përmbajtjen si mëposhte:

## **Shtojca 7**

### **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;

i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

**Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”.**

**Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 03 Datë 09.06.2021 të miratuara nga APP.**

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- b. Formulari i Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Kriteri (1-a) është vendosur në përputhje me Dokumentat e Tenderit të miratuara nga APP bazuar në Vendimit Nr. 03 Datë 09.06.2021 si dhe bazuar në Ligjin Nr.162/2020 “Per prokurimin publik”

Kriteri (1- b) është vendosur në baze të nenit 83 të LPP dhe nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Kriteri (1-c) bazohet në nenet 76, 77 dhe 82 të LPP si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

### **2.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:**

Sipas Shtojcës 7.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Kopje te deklaratave te xhiros vjetore te leshuara nga administrate tatimore pergjate tre viteve te fundit, ku vlera e xhiros per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar duhet te jete **jo me e vogel se 40 % e fondit limit te prokuruar.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosija e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

**2.2.2** Operatori ekonomik duhet të ketë paguar **taksat dhe tarifat vendore për vitin 2023 (këstet e maturuara)** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifat vendore).

**Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.**

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c.

## **2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:**

**2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) **Ne rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin publik,** operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të leshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara,

ose

- b) Në rast se **pervoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat**, si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara.

Kriteri **2.3.1** është vendosur referuar nenit 40 pika 4 dhe nenit 55, pika 4 germa b) të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe bazuar në nenin 77 pika 4 të LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues ka përvojën e duhur për të përmbushur me sukses kontratën.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të **disponojë një automjet të përshtatshëm për transport me kapacitet mbajtës minimalisht 500 Kg**, për transportin e mallit objekt prokurimi, për të cilin duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtme:

- *Aktin e pronësisë së mjetit përkatës;*
- ose
- *Kontratën noteriale të marrjes me qira të mjetit*, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira.

Për mjetet që shënohen në regjistra publike (qoftë në pronësi apo dhe me qira) duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, taksat vjetore si dhe lejen e transportit për ato mjete që pajisen me leje transporti sipas legjislacionit në fuqi.

**Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e automjetit, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.**

Kriteri **2.3.2** është vendosur bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga sasitë e mallit që janë kërkuar si dhe pesha e tyre është parë e nevojshme të kërkohet një automjet i përshtatshëm me tonazh minimalisht 500 kg.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qira/huapërdorje një ambient të përshtatshëm me sipërfaqe minimumi 30 m<sup>2</sup> për magazinimin e mallrave që janë objekt i këtij prokurimi, për të cilin duhet të paraqesë:

a) Në rast se ambienti është në pronësi duhet të paraqesë:

- aktin e pronësisë
- çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin leshuar nga SHMZSH

b) Në rast se ambienti është me qira/huapërdorje duhet të paraqesë:

- kontratën e marrjes me qira/huapërdorje të objektit, e cila duhet të jetë e vlefshme për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës.
- aktin e pronësisë së qiradhenesit/huadhenesit
- çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin leshuar nga SHMZSH

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ligjit nr. 152/2015, datë 21.12.2015 “Për Shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, dhe Udhëzimit Nr.81, datë 06.03.2020 “Për klasifikimin e objekteve, sipas rrezikshmërisë nga zjarri, procedurat e shqyrtimit dhe të miratimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, si dhe dhënia e Certifikatës së Sigurisë nga Zjarri”. Kërkesa për ambientin është kërkuar duke pasur parasysh natyrën dhe përmasat e kontratës, për të siguruar AK një furnizim në vijimësi e të vazhdueshëm.

**2.3.4** - Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar mesatarisht **2** (dy) persona për tre muajt e fundit, për të cilët ofertuesi duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;

**Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e punonjësve, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.**

Kriteri **2.3.4** është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit 77 të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që opertoret ekonomike të deshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund të vihen. Konkretisht: duke qenë se do të nevojitet një mjet për shpërndarjen e mallrave për rrjedhje nevojitet një drejtues mjeti. Gjithashtu për shpërndarjen e mallrave nevojitet minimalisht 1 punëtor për ngarkim shkarkimin e mallrave.

### 2.3.5 Kandidati ofertues duhet te paraqese çertifikaten e meposhtme:

- SSH/EN-ISO 9001-2015“ Sistemi i Menaxhimit te Cilesise” ose ekuivalente, e vlefshme dhe të perputhet me mallin objekt prokurimi.
- SSH/EN-ISO 14001-2015 “Sistemi i Menaxhimit te Mjedisit” ose ekuivalente, e vlefshme dhe të perputhet me mallin objekt prokurimi.

Çertifikata e mesiperme duhet te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.

Kriteri 2.3.5 eshte vendosur ne perputhje me Nenin 40 pika 6 germa c, pika 7 gërma c te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, bazuar ne nenin 44 pika 1 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 si dhe bazuar ne nenin 79 te LPP. Ky kriter eshte vendosur qe AK te kete sigurine qe operatori ekonomik qe do te ofertoje te jete i pajisur me certifikaten e menaxhimit te cilesise gje e cila krijon bindjen dhe sigurine te AK qe ky OE do te ofertoje produkte te certifikuara te nje cilesie te mire e ne perputhje me standartet nderkombetare te cilesise. Kërkesa për çertifikatën ISO 14001 është kërkuar duke pasur parasysh natyrën dhe përmasat e kontratës. Kemi të bëjmë me mallra, të cilat kanë në përbërje substanca të cilat kanë ndikim në mjedis dhe Sistemi i Menaxhimit Mjedisor ISO 14001 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale.

2.3.6 Operatori ekonomik që të vërtetojë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, duhet te paraqese fletët e analizës të lëshuara nga institucione të autorizuar/certifikuara, jo më heret se 6 muaj nga hapja e ofertave, për produktet si mëposhtë:

Nr. sipas Preventivit	Emertimi
1	Detergjent per larje rrobash (pluhur)
2	Sol.larje koridori (1 lit)
3	Sol.Larje xhama
4	Sol.Larje enesh xhel
5	Dezifektues/higjenizues (Acid Klohidrik)
6	Hipoklorit Natriumi (Klor ilenget) 8%
18	Sapun aromatic (90 gr)
22	Sapun te lengshem ( 500ml)

Kriteri 2.3.6 është vendosur referuar nenit 40, pika 6, germa c, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”si dhe bazuar ne nenin 77 te

LPP nr.162,date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”. Kërkesa është propozicion me natyrën dhe permasat e kontratës. Duke u nisur nga substancat që përbejnë këto produkte, të cilat do të përdoren në institucionet arsimore për higjienën e ambienteve apo fëmijëve këto testimet janë të rëndësishme për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit.

### 2.3.7 Operatori ekonomik ditën e zhvillimit të tenderit duhet të paraqesë fizikisht mostrat për artikujt si mëposhte:

Nr. sipas Preventivit	Emertimi
1	Detergjent për larje rrobash (pluhur)
2	Sol.larje koridori (1 lit)
3	Sol.Larje xhama
4	Sol.Larje enesh xhel
5	Dezinfektues/higjenizues (Acid Klorhidrik)
6	Hipoklorit Natriumi (Klor ilenget) 8%
18	Sapun aromatik (90 gr)
22	Sapun të lengshëm ( 500ml)

- Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit në ambientet e AK, Drejtoria e Prokurimeve Publike.
- Cdo mostër e paraqitur pas orarit të përcaktuar për hapjen e procedurës nuk do të pranohet.
- Mostrat e kërkuara duhet detyrimisht të jenë të vullosura me vulën e ofertuesit, emrin e ofertuesit, datën e zhvillimit të tenderit, të nënshkruara në vende të dallueshme dhe të ketë numrin rendor korespondues me emrin e artikullit.
- Mostrat duhet të përputhen me cilësimet e dhëna në specifikimet përkatëse. Nëse mostrat nuk janë sipas specifikimeve OE do të skualifikohen.
- Mosparaqitja e mostrave ditën e zhvillimit të tenderit është kusht për skualifikimin e operatoreve.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6 “a”, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Paraqitja e mostrave kërket për të vërtetuar plotësimin e kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike ku mostra e kërkuar do të shfaqë cilësinë e produktit final i cili do të lëvrohet nga OE fitues gjatë gjithë zbatimit të kontratës.



## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

**Argumentim:** Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Specifikimet teknike hartohen nga specialisti i fushës për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike të përgjithshme të produkteve, kanë të përcaktuara karakteristikat e produktit, përshkrimin e produktit, kërkesat cilësore, sasiore, ambalazhimit, etiketimit.

Specifikimet teknike, për mallrat që kërkohen të realizohen u hartuan në përputhje me kërkesën e Institucionit duke iu referuar nevojave të paisjes me materiale pastrimi lidhur me mbarëvajtjen e procesit të punës.

Specifikimet teknike janë hartuar përgjithësisht në terma funksionalë dhe në vetvete pjesa më e madhe e zërave që do të prokurohen që në emërtimin e tyre e kanë të përfshirë dhe specifikimin teknik, pasi procedura me objekt blerje materiale pastrimi është një procedurë në të cilën zërat që prokurohen janë përgjithësisht të standartizuar dhe të thjeshtë.

Specifikimet teknike për të gjitha produktet janë përcaktuar duke vendosur parametra minimale dhe maksimale, për të patur gjithpërfshirje për çdo operator ekonomik të interesuar, duke përcaktuar diapazon lejues për ofertuesit që ofertojnë këtë produkt me parametra edhe më të larta.

Specifikimet teknike nuk kanë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emri të veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ka ekzistuar një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, dhe është cituar fjala “ose ekuivalent” e përfshirë detyrimisht në këto specifikime.

Specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për mallra të cilat ndihmojnë stafin e AK në proceset e punës së tyre të përditshme. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

## NJESIA E PROKURIMIT